



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës,

**th ë r r e t**

mbledhjen e **dytë** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **03.03.2020** dhe do të fillojë në orën **11:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën nr. 37 (kati II) të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

**REND TË DITËS:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Bajram Gashanit dhe "AL TRADE HOLDING" L.L.C.;
3. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Salih Grajqevci, Gani Azemi, Avni Azemaj, Adnan Maxhuni, Gent Azemaj dhe Alban Beci;
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Tafil (Arif) Osmani.
5. Propozimvendimi për miratimin e planit komunal për riintegrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Komunën e Prishtinës 2020-2022;
6. Propozimvendimi për miratimin e planit komunal të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2020-2022;
7. Propozimvendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
8. Propozimvendimi për miratimin e ndarjes së subvencionimit për transportimin e donacionit në mallra për personat me aftësi të kufizuara;
9. Diskutim për raportin vjetor të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
10. Diskutim për raportin vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019;
11. Të ndryshme.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS  
01-060/01-49103/20, më 28.02.2020

KRYESUESI I KOMITETIT  
Agim Kuleta

Faqe 1 nga 1

